

Hapet Thirrja për aplikime për stafin akademik dhe administrativ të Universitetit të Tiranës në Universitetin e Luksemburgut, në kuadër të programit Erasmus+

Në kuadër të programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik dhe administrativ të Universitetit të Tiranës në Universitetin e Luksemburgut.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit akademik dhe administrativ për trajnim;

Kohëzgjatja e bursave:

- Shkëmbimin e stafit akademik dhe administrativ për trajnim (5 ditë + 2 ditë udhëtim);

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor (140 EUR në ditë për stafin);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim **për stafin akademik dhe administrativ për trajnim:**

- CV+ lista e publikimeve për stafin akademik (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);

- Vërtetimi Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohuritë e gjuhës angleze në nivelin B2;
- Plani i mobilitetit për trajnim*;

**Mobility Plan është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen gjatë periudhës së mobilitetit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus + Z. Elton Skendaj.*

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Trajnim klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Training_Mobility_Plan.pdf

Afati për aplikim: 13 Prill 2018

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Zyrën për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!